

20190270369

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR

### Neni 1

Në Kodin zgjedhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 40/2006, 136/2008, 148/2008, 155/2008, 163/2008, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18 dhe 208/18), në nenin 76-v paragrafi (1) fjalët: “ndërsa Komisionit Shtetëror për Mediume Elektronike (internet portalet),” shlyhen.

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (3).

Paragrafi (5) shlyhet.

Paragrafët (6), (7), (8) dhe (9), bëhen paragrafë (4), (5), (6) dhe (7).

Paragrafi (10) që bëhet paragraf (8), ndryshohet si vijon:

“(8) Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele obligohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të këtij kodi, të miratojë Metodologji për monitorim të prezantimit zgjedhor mediatik nëpërmjet serviseve programore të radios dhe televizionit, gjatë kohës së proceseve zgjedhore dhe të njëjtat i publikon në faqen e vet të internetit.”.

### Neni 2

Në nenin 76-d në paragrafin (1) fjalët: “pas fjalëve Buxhetit të Republikës së Maqedonisë” presja zëvendësohet me pikë dhe teksti deri në fund të fjalisë shlyhet.

Paragrafi (3) shlyhet.

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragraf (3) fjalët: “Ministria e Financave” zëvendësohen me fjalët: “Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve”.

Pas paragrafit (4) që bëhet paragraf (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

“(4) Para pagesës së shpenzimeve për reklamimin e paguar politik të publikuar sipas paragrafit (3) të këtij neni, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele obligohet që të paraqesë raport për reklamimin e paguar politik të publikuar të radiodifuzerëve në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, në ditën e dhjetë nga dita e fushatës zgjedhore dhe në ditën e shtatë pas mbarimit të fushatës zgjedhore.”.

Në paragrafin (5) fjalët: “Ministria e Financave” zëvendësohen me fjalët: “Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve”.

### Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.